



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



RAPORTI I PËRGJITHSHËM I AKTIVITETEVE

15 SHTATOR - 15 DHJETOR 2018

Përgaditur nga
Lets do It - Ta Pastrojmë Kosovën

Adresa: Pejton Rr. Mujo Ulqinaku 118 Dardania 1. - obj. B/3 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381 (0) 38 40 00 22
info@letsdoitkosova.org | www.tapastrojmekosoven.org

10 JANAR 2019

PËRMBAJTJA

Akronimet	3
Përmbledhja Ekzekutive	4
Hyrje	5
Përmbledhje e rezultateve dhe të arrituarave	6
Sfidat dhe mundësitë	7
Aktivitet tjera në kuadër të fushatës	8
Deponitë e përcaktuara	9
Komunat me plane për mbledhje	10
Storie Suksesi	11
Deponitë e larguara	12
Tani e tutje	13
Aktivitetet 15 shtator – 15 dhjetor, 2018	14
Angazhimet e komunave	15
Aktivitet 15 shtator – 15 dhjetor 2018	17-69

AKRONIMET

AGK	Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
IFK	Iniciative e Femrës Kosovare
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
LDI	Let's do It
LDIW	Let's do It Word
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
TPK	Ta Pastrojmë Kosovën
SHC	Shoqëria Civile
SHFMU	Shkolla Fillore e Mesme e Ulët
UA	Urdhëresa Administrative

I. PËRMbledhje Ekzekutive

Pastrimi i Kosovës nga mbeturinat dhe largimi i deponive ilegale nuk ka qenë prioritet në të kaluarën nga ana e shoqërisë kosovare dhe institucioneve të saj. Largimi i mbeturinave nga ana e komunave dhe pastrimi i hapësirave publike nga mbeturinat është kryer sipas planit për pastrim që kanë pasur komunat, në bazë të kontratave të rregullta me kompani pastrimi. Mirëpo sasia e mbeturinave e krijuar nga qytetarët e posaçërisht nga subjektet afariste të pandërgjegjshme të cilat kanë hedhur mbeturina vend e pa vend, ka tejkaluar kapacitetet e kompanive të pastrimit dhe të komunave, përfshirë këtu edhe fushatat e njëpasnjëshme të Let's Do It për pastrimin dhe largimin e deponive ilegale. Që nga viti 2012, Let's Do It ka avokuar për mjedis të pastër dhe theksin e ka vënë në menaxhimin e mbeturinave në mënyrë efektive. Janë ndërmarrë aksione të panumërta pastrimi të deponive gjithandej Kosovës për të tërhequr vëmendjen e publikut, për të ruajtur mjedisin dhe respektuar rregullat mjedisore. Let's Do It ka ndërmarrë aksione pastrimi në secilin vit, duke angazhuar me mijëra qytetarë e vullnetarë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Përkundër aksioneve të pandërprera çdo vit, deponitë kanë vazhduar të përsëriten vazhdimisht edhe në hapësirat ku ishin pastruar më parë. Pas gati 20 viteve nga lufta dhe një dekadë prej se është shpallur pavarësia e Kosovës, situata me mbeturinat dhe deponitë ilegale më në fund ka filluar të ndryshojë

për të mirë. Qeveria e Kosovës me kryeministër Ramush Haradinaj, ka vendosur si prioritet pastrimin dhe largimin e deponive ilegale në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Reagimi i Qeverisë së Kosovës është mirëpritur nga të gjitha komunat, përfshirë qytetarët. Si rezultat, janë themeluar 32 Task Forca komunale, të udhëhequra nga zyrtarët më të lartë komunal për të adresuar çështjen e mbeturinave dhe deponive ilegale.

Largimit të mbeturinave nga ana e institucioneve qëndrore dhe atyre lokale i është dhënë vëmendje e plotë dhe e duhur për t'u zgjidhur si problem shoqëror. Edhe pas përfundimit të fushatës, komunat së bashku me Let's Do It kanë vazhduar të fokusohen në eliminimin e deponive të mbetura ilegale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke synuar që gjatë vitit 2019 të mos mbetet asnjë e tillë. E për të mbështetur këtë angazhim, institucionet relevante kanë filluar me intensitet më të shtuar zbatimin e Udhëzimit Administrativ MMPH – nr. 14/2015 për Ndëshkime me Gjopa Mandatore. Duke u zbatuar kuadri ligjor kundrejt ndotësve mjedisor, do të arrihet që Kosova të vendoset në hartën e vendeve me mjedis të pastër nga mbeturinat dhe do të krijohet mundësia që vendi të fokusohet në shqetësimet e tjera mjedisore që ka, si: ujërat, ajri dhe mbrojtja e pyjeve. Për më tepër, fushata Ta Pastrojmë Kosovën ka arritur që të mobilizojë dhe të krijojë sinergji në mes të institucioneve lokale

dhe qëndrore, shoqërisë civile e sektorit të biznesit që bashkërisht t'i qasen largimit të mbeturinave nga vendet ilegale. Vullnetarët kanë luajtur rol kritik gjatë gjithë kohës së fushatës duke u angazhuar drejtëpërdrejtë në pastrimin e hapësirave publike nga mbeturinat, përfshirë edhe ndikimin që kanë ushtruar tek rrethet e tyre për pjesëmarrje në aktivitete pastrimi si dhe ndikimin për të ndërruar shprehite e hudhjes së mbeturinave në vendet ku nuk është e lejuar. Fushata e pastrimit nga mbeturinat prej vendeve ilegale ka patur jehonë në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Qytetarët kanë marrë pjesë në aksione dhe kanë dhënë ide e sugjerime se si duhet të përmirësohet puna jonë në të ardhmen. Ndër të tjera, Let's Do It në kuadër të fushatës ka organizuar tryeza me qytetarë e institucione, ka mbajtur debate të panumërta në televizionet lokale, qendore dhe radio, ka organizuar trajnime me nxënës dhe mesimdhënës në shkolla fillore, të mesme të ulta dhe të mesme të larta gjithandej Kosovës, me qëllim që të nxisë e mobilizojë shoqërinë për një mjedis të qëndrueshëm. Për më tepër, Fushata ka arritur të dëshmojë se shoqëria jonë është në gjendje të bashkëpunojë për të trajtuar sfida që i brengosin ata dhe mjedisin ku jetojnë. Konkretisht, institucionet lokale dhe ato qëndrore, përfshirë shoqërinë civile, qytetarët dhe kompanitë e pastrimit kanë dëshmuar se mund të bashkëpunojnë dhe të ndajnë përgjegjësi për të arritur qëllime me rëndësi publike.



II. HYRJE

Duke pasur parasysh sukseset e viteve të kaluara që ka arritur fushata e pastrimit të mbeturinave nga lokacionet ilegale, si dhe duke pasur parasysh se problemi i mbeturinave dhe deponive ilegale vazhdonte të ishte njëra ndër problemet mjedisore të pazgjidhura të shoqërisë kosovare, Let's Do It ka adresuar radhazi këtë problem në institucionet lokale dhe qëndrore në Kosovë duke kërkuar që të ndërmerren veprime përmbytësore lidhur me mbeturinat dhe që ato veprime të hapin rrugën për zgjidhje të problemit të mbeturinave dhe deponive ilegale gjithandej Kosovës. Me dhjetëra takime janë mbajtur me Qeverinë e Kosovës dhe institucionet e tjera relevante për të ndarë vizionin e fushatës Ta Pastrojme Kosovën. Pas analizimit të rezultateve dhe synimeve të Let's Do It, Qeveria e Kosovës vendos që ta mbështesë fushatën Ta Pastrojme Kosovën dhe që kjo fushatë të zgjasë tre muaj, prej datës 15 shtator deri më 15 dhjetor, 2018. Inkuadrimi i Qeverisë së Kosovës dhe i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor filloi që në ditët e para të fushatës duke vazhduar kështu edhe me involvimin e institucioneve të tjera relevante. Pas shumë përpjekjeve dhe diskutimve të rregullta me institucione relevante, në verën e vitit 2018 Let's Do It merrë mbështetje të fuqishme nga Kryeministri i Kosovës dhe zotimin se ai personalisht me kabinetin e tij do të përkrasin të gjitha operacionet e fushatës për të siguruar një Kosovë më të pastër si dhe ka marrë vendim për pjesëmarrjen e të gjithë shërbyesëve civil në aksionin e

15 shtatorit, 2018. Në këtë fazë, Let's Do It me mbështetjen e kryeministrit Ramush Haradinaj filloi angazhimet për të punuar me të gjitha institucionet relevante për të dizajnuar planin operacional të pastrimit tre mujor të Kosovës, nga mbeturinat dhe deponitë ilegale. Pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për themelimin e Task Forcës e cila është përbërë prej 12 akterëve institucional dhe shoqërisë civile dhe e koordinuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, edhe 32 komuna tjera vendosën për të themeluar Task Forca vetanake në mënyrë që të menaxhojnë punën në terren. Të gjithë akterët komunal kanë hartuar planin tre mujor të aktiviteteve për implementim të aksionit Ta Pastrojme Kosovën që për synim ka patur rritjen e angazhimit të institucioneve për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, organizimin e qytetarëve për adresimin e problemeve mjedisore, pjesëmarrjen në aksione të pastrimit si dhe aktivitete tjera mjedisore me fokus të veçantë trajtimin e mbeturinave si dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëra.

Më datën 15 shtator, 2018 aksioni Ta Pastrojme Kosovën kishte paraparë që të shtrihet në tërë territorin e Republikës së Kosovës, me synimin që të largohen mbeturinat përreth të gjitha objekteve të institucioneve publike. Qeveria e Kosovës mori vendim që më 15 shtator 2018, në aksione pastrimi të marrin pjesë të gjithë shërbyesit civilë si dhe nxënësit e studentët. Më tutje, vendimi parashihte që të gjitha mbeturinat e grumbulluara me datën 15 shtator 2018, të merren nga ndërmarrjet

publike për menaxhimin e mbeturinave dhe të dërgohen pa pagesë në deponitë regjionale. Mjetet logjistike për aksionin e datës 15 shtator 2018, janë shpërndarë në të gjitha komunat dy ditë para aksionit të pastrimit dhe ishte vendosur që në të gjitha komunat e Kosovës aksionet të hapen nga kryetarët e komunave dhe më pas të shpërndahen nëpër lokacionet e përcaktuara për pastrim. Duke patur parasysh përvojën e mëparshme me fushata të pastrimit të Let's Do It, qindra vullnetarë dhe organizata të shoqërisë civile u mobilizuan për të kontribuar në këtë fushatë. Në secilën komunë, fushata kishte angazhuar koordinatore lokal të cilët janë kujdesur për pjesën teknike të organizimit në qendrën e thirrjeve ku gjatë tërë ditës janë mbledhur informacione për mbarëvajtjen e aksionit, numrin e vullnetarëve dhe sasinë e mbeturinave të larguara. Fushata Ta Pastrojme Kosovën është përcjellur nga të gjitha mediat lokale të shkruara dhe elektronike e mbështetur nga aktivitete vetëdijësuese, si video promotionale, përmes të cilave është bërë thirrje për pjesëmarrje në aksionet e pastrimit dhe është transmetuar në të gjitha televizionet e Kosovës, prezenca e eksponentëve të fushatës Ta Pastrojme Kosovën është bërë edhe në serialin televiziv "O Sa Mirë" me temën e ruajtjes së mjedisit, janë përfshirë artistë, sportistë dhe figura publike në fushatën vetëdijësuese dhe në aksionet e pastrimit. Në konferencën përmbyllëse do të bëhet prezantimi i rezultateve si dhe do të ndahen çmimet për komunat fituese të grantit të MMPH-së.



III. PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE DHE TË ARRITURAVE

Let's Do It ka aplikuar metodologjinë e standardizuar të fushatës së pastrimit dhe largimit të deponive ilegale. Në fushatë janë angazhuar të gjitha institucionet relevante në nivel qendror dhe lokal dhe vullnetarët e Let's Do It në tërë territorin e Kosovës, përfshirë komunitetet jo shumicë.

- Ndër rezultatet kryesore dhe të arriturat e Fushatës prej 15 shtator deri më 15 dhjetor 2018, janë si në vijim:
- Në tërë Kosovën, janë larguar 952 deponi ilegale;
- Janë angazhuar 195,000 vullnetarë ose rreth 10.78% e popullësisë së përgjithshme në Kosovë;
- Janë themeluar 32 Task Forca komunale të cilat do të shërbejnë edhe në të ardhmen për t'u angazhuar në programe tjera në të mirë të publikut dhe mjedisit;
- Qështjet mjedisore që preokupojnë publikun në Kosovë janë prioritet, ndërsa mjedisi është në agjendë të politikës ditore kosovare;
- Aksioni Ta Pastrojmë Kosovën ka krijuar rrjete lokale mjedis-

ore të cilat janë të gatshme të marrin përsipër detyra të reja për të mbrojtur dhe avansuar mjedisin;

- Aksioni ka angazhuar numër rekord të grave dhe komuniteteve jo shumicë në mbrojtje të mjedisit;
- Aksioni Ta Pastrojmë Kosovën është partneriteti më i suksesshëm ndërmjet institucioneve qeveritare, atyre lokale, bizneseve, kompanive publike dhe shoqërisë civile në historinë e re të Kosovës;
- Fushata ka pasur mbulim ditor të mediave;
- Qytetarët e Kosovës po raportojnë ndotësit e mjedisit në Let's Do It dhe institucionet relevante;
- 22 komuna kanë përcaktuar lokacione për deponi inerte ilegale;
- 26 komuna kanë zhvilluar plane për mbjellje të fidaneve dekorative;
- Aksioni Ta Pastrojmë Kosovën ka kthyer besimin e bashkëpunimit ndërsektorial dhe është model se si duhet që në si shoqëri t'i qasemi sfidave tjera shoqërore bashkarisht.



Aksioni Ta Pastrojmë Kosovën është shpallur fushata më e suksesshme në mesin e 158 shteteve tjera në botë nga Let's Do It World:

<http://tapastrojmekosoven.org/2018/12/fushata-ta-pastrojme-kosoven-shpallet-e-suksesshmja-ne-bote-nga-lets-world/?fbclid=IwAR2tAiMma2Wi0DDte030HLnBthxSxytiDiZE4cYiGwNUVbUWqpWu5FjkHDA>

IV. SFIDAT DHE MUNDËSITË

Ndër detyrat kryesore që janë të parapara është implementimi i Urdhëresës Administrative për Ndëshkime me Gjoha Mandatore e nënshkruar nga Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kjo urdhëresë, edhe pse ka filluar të zbatohet nga shumë komuna dhe institucione tjera relevante, mbetet të implementohet nga të gjitha institucionet lokale e qendrore sa më parë që është e mundur dhe në kuptim të plotë e intensive, në mënyrë që të sigurohet që personat dhe subjektet afariste të papërgjegjshme të ndalin veprimet e

tyre të hudhjes së mbeturinave në vende jo të destinuara dhe të marit dënimin e merituar. Është jetike që pa humbur kohë Udhëzimi Administrativ për Gjoha Mandatore të jetësohet në kuptimin e saj të plotë. Poashtu, institucionet duhet që të rrisin angazhimin e tyre drejt implementimit të të gjithë kornizës mjedisore e cila mbron dhe promovon mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm në Kosovë. Vetëm në këtë mënyrë do të rrisim besimin tek shoqëria jonë, aq sa është e mundur, që mjedisit t'i kthejmë qëndrueshmërinë duke punuar

së bashku. Në anën tjetër si shoqëri, para vetes kemi mundësinë që duhet për të angazhuar qytetarët, institucionet dhe sektorin e bizneseve të kontribuojnë bashkërisht për mjedis të qëndrueshëm, për të cilën Let's Do It konsideron se shoqëria kosovare me mbështetjen e institucioneve është e gatshme si asnjëherë më parë. Suksesi i fushatës Ta Pastrojmë Kosovën duhet të jetë motiv për t'u angazhuar të gjithë si shoqëri, që ky model të vazhdoj dhe të zgjerohet në sfida tjera mjedisore.

“Ky aksion tre mujor ka qënë aksion i domosdoshëm për vendin tonë i cili i ka plotësuar të gjitha kriteret. Mendoj që aksioni duhet të zgjasë edhe vitin e ardhshëm duke e mbështetur me gjobitje te qytetarëve të pandërgjegjshëm, dhe kjo do të ishte më efektive”.

**AMIR PLANA,
DREJTOR SHKOLLA E MESME E ULËT “HIVZI SYLEJMANI”, FUSHËKOSOVË**



AKTIVITETE TJERA NË KUADËR TË FUSHATËS

Let's Do It dhe AGK ndajnë çmimet për storiet më të mira për mjedisin Në kuadër të Fushatës Ta Pastrojmë Kosovën, Let's Do It në bashkëpunim me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës [AGK] kanë bërë ndarjen e çmimeve për storiet më të mirë për mjedisin. Çmimin e parë e ka fituar gazetarja e Kohavisionit, Drita Slivova Polisi me dokumentarin 21 minutësh "Ajri që vret", çmimin e dytë e fitoi gazetarja e Televizionit 7, Florandë Morina me storien "Bellopoja e ndotur", çmimin e tretë e fitoi gazetarja e Gazeta Insajderi, Drenusha Canolli me storien "Një nga një deri në

asnjë - rrugëtimi për Kosovën e pastër, ndërsa çmimin e katërt e fitoi gazetarja e Klan Kosovës, Mejreme Gashi me storien "Automekaniku vullnetarisht mirëmban Hogoshtin". Përveç çmimeve për storiet fituese, Let's Do It në këtë konferencë u ka ndarë mirënjohje të gjithë gazetarëve që kanë aplikuar në konkurs Gazetarja e Kohavisionit, Drita Slivova Polisi, e cila fitoi çmimin e parë në këtë konkurs, është shprehur e lumtur me fitimin e këtij çmimi, të cilin ia ka dedikuar vajzës së saj të vogël, Ridës. Përveç falenderimit për Let's Do It dhe AGK-në për ndarjen e këtij

çmimi, Slivova Polisi falënderoi edhe ekipin e televizionit ku ajo punon për punën e palodhshme të tyre. Ndërsa, fituesja e çmimit të dytë në këtë garë, gazetarja e T7, Florandë Morina, tha se do të vazhdojë trajtimin e problemeve mjedisore, derisa falënderoi televizionin ku punon për hapësirën që ua jep për trajtimin e këtyre çështjeve. E lumtur për çmimin u shpreh edhe gazetarja fituese e çmimit të tretë, Drenusha Canolli, e cila po ashtu premtoi se do të vazhdojë trajtimin e temave nga fusha e mjedisit.



DEPONITË E PËRCAKTUARA

Gjithashtu, si pjesë e fushatës Ta Pastrojmë Kosovës, është kërkuar nga komunanat që të përcaktojnë deponi e tyre legale për trajtim të mbeturinave inerte. Më poshtë është lista e komunave që kanë arritur të përcaktojnë lokacionet e deponive:

NR.	KOMUNA	LOKACIONI I DEPONISË
1.	Prishtinë	Deponia në fshatin Drenoc
2.	Prizren	Deponia Zhur
3.	Ferizaj	Deponia në Lloçkobare
4.	Pejë	Fshati Sverkë
5.	Gjakovë	Deponia në fshatin Vugovë
6.	Gjilan	Fshati "Bara" deponia në Kmetovc
7.	Mitrovicë	Deponia në fshatin Gërmovëv
8.	Podujevë	Deponia në fshatin Llaushë dhe Sallabajë
9.	Vushtrri	Fshati Pestovë Fshati Strofc
10.	Suharekë	Zona Industriale – Shirokë
11.	Rahovec	Ravne Shume 62661 m2 Ravne Shume 10788 m2 Senjane 25330 m2
12.	Drenas	Deponia në Lllapushnik
13.	Lipjan	Deponia në Kraishtë
14.	Malishevë	Deponia në fshatin Astrazup (nr. i kadastrës 1034 dhe 1035)
15.	Kamenicë	Zona kadastrale, paralagja e qytetit – Derivojcë
16.	Viti	Deponia në Binq Deponia në Radivojc Deponia në Sadovinë e Qerkezve Deponia në Gjylekar
17.	Decan	Deponia në Lepushë
18.	Istog	Rudesh, mbi varrezat e qytetit
19.	Klinë	Magjistralja Pejë-Prishtinë në vendin e quajtur afër vishnjeve
20.	Skenderaj	Fshati Qirez
21.	Shtime	Deponia në Belincë
22.	Junik	Shkozë e Vokshit

Ndër të tjera, aksioni Ta Pastrojmë Kosovën ka inicuar garë ndërmjet Komunave të Kosovës më të suksesëshme në zbatimin e aksionit të pastrimit të Kosovës. Fushata ka paraparë që për pesë komunat më të suksesëshme në pastrimin e deponive ilegale dhe organizimin e aktiviteteve tjera vetëdijesuese Min-

istria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të ndajë grante. Poashtu, ha hyrë në fuqi Udhëzimi Administrative për ndëshkimet me gjoba mandatore si dhe është lansuar platforma: www.kallxogjelbër.com dhe aplikacioni trashout.

Komunat me plane për mbjellje

Më poshtë ëshë lisat e komunave të cilat gjatë fushatës Ta Pastrojmë Kosovën kanë zhvillura plane për mbjelljen e bimë dhe fidaneve.

NR.	KOMUNAT ME PLAN PËR MBJELLJE
1.	Drenas
2.	Ferizaj
3.	Gjakovë
4.	Gjilan
5.	Hani Elezit
6.	Istog
7.	Junik
8.	Kaçanik
9.	Kamenicë
10.	Klinë
11.	Lipjan
12.	Malishevë
13.	Mitrovicë
14.	Mitrovicë Parku Botanik
15.	Novobërdë
16.	Obiliq
17.	Pejë
18.	Podujevë
19.	Prishtinë
20.	Prizren
21.	Rahovec
22.	Shtërpc
23.	Skënderaj
24.	Suharekë
25.	Viti
26.	Vushtrri




Fushata Ta Pastrojme Kosovën shpallet më e suksesshmja në botë nga Let's Do It World

Let's do It Word (LDIW) ka shpallur fushatën Ta Pastrojme Kosovën si njëren nga fushatat më të suksesshme në botë në vitin 2018 në mesin e qindrave vendeve të botës që janë pjesë e kësaj Lëvizje Globale. Në njoftimin e Let's Do It Eord përmendet pjesëmarrja masive e qytetarëve të Kosovës në këtë Fushatë që zgjati nga 15 shtator, 2018 deri më 15 dhjetor, 2018. Fushatës Ta Pastrojme Kosovën përgjatë këtyre tre muajve iu bashkuan mbi 195 mijë vullnetarë, apo rreth 10.7 për qind e popullsisë së vendit. Ekipi i Let's Do It në Kosovë operon në kuadër të rrjetit të Let's Do It World, ndërsa për punën e

suksesshme të këtij viti do të shpërbehet me çmim nga kjo Lëvizje Globale, më 24 janar kur edhe mbahet Konferenca për pastrimin e botës, ku marrin pjesë përfaqësues nga 158 shtete të ndryshme. Let's Do It World përmend qindra aksionet që u organizuan në Kosovë në kuadër të kësaj Fushate, e cila këtë vit për dallim prej herëve të tjera u organizua në bashkëpunim me institucionet, si dhe është financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Rezultati citohet si mbresëlënëse, falë punës dhe përkushtimit shumë të madh të të gjithë atyre që kanë qenë të përfshirë. Në njoftimin e Lets do it Eord përmendet

krijimi i Task Forcës nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ku u bën bashkë Ministri përkatëse dhe shoqëria civile, të koordinuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të vendit. Kjo histori frymëzuese është testament për potencialin e lëvizjes Let's Do It si një forcë pozitive për të mirën. Bukuria e saj qëndron në fuqinë e njerëzve të zakonshëm për të arritur gjëra të pabesueshme duke u bashkuar – bashkëpunuar, dhe ndërtuar ura midis të gjitha niveleve të shoqërisë”, thuhet tutje në njoftimin e Let's Do It World për Fushatën Ta Pastrojme Kosovën, më të suksesshmen në botë.



News Press Releases Newsletter Media Coverage Promo Materials

Kudos to Kosovo – 10% of the country gets active

New statistics from Let's Do It Kosovo show that their team was the most successful in engaging its citizens to participate in World Cleanup Day activities and beyond, getting the highest percentage of citizens out to clean – a massive 10.78% of the country's population: 195,000 people.

Let's Do It Kosovo has particularly active been within the Let's Do It network and addressing the huge problems of waste management and illegal dumping of trash very seriously. Cooperation with governmental departments has been at the forefront of their strategy and is leading to impressive results, thanks to much hard work and dedication from all involved.

Choose a language:

English

15 December 2018, 17:14



Tabela më poshtë paraqet numrin e deponive ilegale të larguara sipas komunave:

Nr	Komuna	Numri i Deponive të larguara:
1	Deçan	20
2	Dragash	3
3	Drenas	20
4	Ferizaj	45
5	Fushë Kosovë	10
6	Gjakovë	128
7	Gjilan	17
8	Graçanicë	5
9	Hani i Elezit	7
10	Istog	30
11	Junik	22
12	Kaçanik	10
13	Kamenicë	60
14	Klinë	26
15	Klllokot	2
16	Leposaviq	3
17	Lipjan	20
18	Malishevë	24
19	Mamushë	0
20	Mitrovica e Veriut	3
21	Mitrovicë	20
22	Artanë	5
23	Obiliq	32
24	Partesh	2
25	Pejë	36
26	Podujevë	10
27	Prishtinë	122
28	Prizren	33
29	Rahovec	23
30	Ranillug	2
31	Shtërpc	4
32	Shtime	30
33	Skënderaj	59
34	Suharekë	58
35	Viti	26
36	Vushtrri	30
37	Zubin Potok	2
38	Zveçan	3
Gjithsej:		952

DEPONITË TË LARGUARA



TANI E TUTJE?

Progresi në Transformimin Mjedisor

Përpjekjet kosovare për të siguruar përmirësim të gjendjes mjedisore në Kosovë, janë shpresëdhënëse. Institucionet e Kosovës kanë filluar që temat mjedisore t'i vendosin në agjendat e tyre komunale dhe qeveritare. Çdo ditë e më

shumë, akterët vendor dhe ndërkombëtar, përfshirë shoqërinë civile dhe mediat janë duke trajtuar temat mjedisore. Let's Do It mbetet e përkushtuar ndaj misionit të saj për Kosovë me mjedis të qëndrueshëm, dhe për të arritur qëllimin

e saj do të punojë me secilin akter vendor dhe ndërkombëtar. Në këtë përpjekje, kritik është roli i institucioneve lokale e qendrore, përfshirë edhe ato ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës.



AKTIVITETET

15 SHTATOR – 15 DHJETOR 2018



Aksioni i përgjithshëm i pastrimit dhe largimit të deponive dhe mbeturinave ka filluar me datën 15 shtator 2018, në të gjitha komunat e Kosovës, përfshirë edhe komunat me shumicë serbe. Gjatë aksionit, në të cilin morën pjesë më shumë se 100.000 vullnetarë, janë larguar mbi 150 deponi dhe mbi gjashtë mijë (6,000) ton me mbeturina, të konfirmuara nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK).

Hapja zyrtare e aksionit më të madh të pastrimit është bërë në Prishtinë në lagjen Emshir, nga kryeministri z. Ramush Haradinaj dhe Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, z. Fatmir Matoshi. Në hapjen zyrtare përveq Kryeministrit dhe Ministrit, ishin prezentë edhe ministra të tjerë të Qeverisë së Kosovës. Gjithash-tu, në këtë aksion mori pjesë edhe Min-

istri i Turizmit dhe i Mjedisit në Shqipëri, Blendi Klosi me një grup të vullnetarëve, Ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Për Strand Sjaastad, përfaqësues të KFOR-it, FSK-së, Policisë së Kosovës, organizatave të ndryshme të shoqërisë civile, kompanive private, nxënës të shkollave fillore dhe të mesme dhe studentë. Aksioni filloi në lagjen Kalabria në Prishtinë, ku nga aty u largua deponia më e madhe me mbetje inerte në kryeqytet, me gjithsej 106 kamionë mbeturina. Më pas, vullnetarët kanë vazhduar në zonën industriale në Fushë Kosovë tek rrethotullimi dhe ura, prej nga janë larguar 6 kamionë me mbetje nga ana e FSK-së. Më 15 shtator 2018 në Prishtinë, përveç deponisë në Kalabri dhe asaj në zonën industriale në Fushë Kosovë, aksioni Ta Pastrojmë Kosovën ka vazhduar edhe në 12 pika të tjera:

Është larguar deponia te parkingu i Stadiumit të Prishtinës, afër Sheshit 21, është larguar deponia te Fusha e Pajtimt, deponia në hyrje të Parkut të Gërmisë, deponia përgjatë linjës hekurudhore në magjistralen M2, deponia prapa Komunës së Re të Prishtinës, mbeturinat përballë American University in Kosovo AUK-ut, deponia tek tregu i automjeteve, deponia afër Beni Dona, deponia përballë shkollës së mesme të ulët "Asim Vokshi" në Kodrën e Trimave, mbeturinat në hapësirat e Kampusit Universitar, deponia tek Rruga B (Banesat e Bardha), deponia te Lagjia Arbëria (rruga dytësore), deponia te rrethi në Dragodan- magjistralja M2. Sikurse në Prishtinë ku është lansuar aksioni, edhe në komunat tjera aksioni ka filluar më 15 shtator 2018 dhe kanë marrë pjesë zyrtarë komunal, si kryetarët e komunave,

"Jam e privilegjuar dhe me fat që më është dhënë mundësia të jem pjesë e fushatës Ta Pastrojmë Kosovën dhe të takoj qytetarë që me punën dhe përkushtimin e vazhdueshëm, arritën ta vendosin Kosovën në hartën botërore me lajme të mira"- Valbona Mustafa, vullnetare.

drejtorët e drejtorive, nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, OJQ dhe shoqata, kompani publike dhe private dhe shoqëria civile. Gjithashtu, Fushata ka vënë në dispozicion numra të telefonit, emaile dhe webfaqen www.tapastrojmekosoven.com, për të gjitha palët e interesura për t'u bërë pjesë e aksionit të pastrimit. Për më tepër, Let's Do It kishte siguruar transport dhe të gjitha mjetet logjistike për mbarëvajtje dhe realizim të aksionit tre mujor. Sa i përket menaxhimit të mbe-

turinave të grumbulluara, Ministria për Zhvillim Ekonomik kishte vendosur që të gjitha mbeturinat e grumbulluara në aksionet e pastrimit të dërgoheshin në deponitë regionale përmes ndërmarrjeve të pastrimit, pa pagesë. Në aksionet e pastrimit të datës 15 shtator 2018 dhe deri në përfundim të fushatës së pastrimit, për pjesëmarrësit janë siguruar mjete të nevojshme logjistike, si thasë, dorëza, maica, krerëse, lopata, çizme, uniforma pune, ujë dhe shujtë ushqimi. Gjatë mua-

jve në vazhdim, vëmendje do të ju kush-tohet pastrimit të lumenjve dhe kanaleve të ujitjes, task forca do të hartojë plan të detajuar për pastrimin e tyre. Ndër të tjera, aksione të pastrimit janë organizuar edhe nga komunat me shumicë serbe, organizatat e shoqërisë civile të komuniteteve jo shumicë. Për të koordinuar aktivitetet dhe aksionet e pastrimit në të gjitha komunat me shumicë serbe, fushata Ta Pastrojmë Kosovë ka emëruar koordinatoren nga komuniteti serb.

ANGAZHIMET E KOMUNAVE

Task Forcat komunale kanë mbajtur takime të rregullta koordinuese duke marrë parasysh se komunat kanë pasur rol kyq në zbatimin e aksioneve të pastrimit dhe mobilizimit të resurseve lokale. Me përfaqësuesit e këtyre task forcave janë diskutuar aktivitetet, sfidat dhe mbarëvajtja e aksioneve të pastrimit

në nivele komunale dhe në nivel nacional. Komunat kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me ekipin e Let's Do It në nivel qendror dhe komunal, si dhe kanë koordinuar aktivitetet me koordinorët lokal. Poashtu, shumica e komunave me sukses kanë përcaktuar lokacionet e deponive interte legale (22 komuna), ku edhe do të le-

johet shkarkimi i mbeturinave ndërtimore. Për më tepër, të gjitha komunat pa dallim kanë bashkëpunuar me bashkësitë lokale, kompanitë e pastrimit, shkollat, shtëpitë e shëndetit, policinë e të tjerë akterë për të siguruar suksesin e aksioneve të pastrimit.



SHPËRNDARJA E SHPORTAVE DHE KONTENJERËVE

Përveç dhjetë komunave të cilat ishin fituese të grantit 1.2 milionë euro të ndarë nga MMPH-ja si rezultat i angazhimit dhe përkushtimit të tyre në fushatën e pastrimit, projekti "Ta Pastrojmë Kosovën" ndau 500 shporta dhe 500 kontenjerë për dhjetra komuna të tjera duke marrë

poashtu për bazë punën e sukseshme që treguan ato gjatë projektit tremujorë të pastrimit "Ta Pastrojmë Kosovën" 15 shtator - 15 dhjetor 2018. Shpërndarja e shportave dhe kontenjerëve u bë më datë 26.04.2019, në "Javën e Tokës" si simbolikë të rritjes sa më të madhe të kujdesit

ndaj saj.

Komunat fituese të shportave dhe kontenjerëve ishin: **Hani i Elezit, Podujeva, Istogu, Skënderaj, Malisheva, Peja, Rahoveci, Lipjani, Shtimja, Deqani, Prizreni, Mitrovica, Prishtinë, Istog etj.**



SHPËRNDARJA E RROBAVE PËR PUNTORËT E KOMPANIVE E PASTRIMIT



Gjatë projektit "Ta Pastrojmë Kosovën" 15 shtator - 15 dhjetor 2018, u shpërndanë edhe 1000 palë rroba për punëtorët e Kompanive të Pastrimit si dhe për vullnetarët të cilët u angazhuan në aktivitetet për pastrimin e vendit.



KONFERENCA PËRMBYLLËSE E PROJEKTIT “TA PASTROJMË KOSOVËN”, 15 SHTATOR – 15 DHJETOR 2018

Më datë 10.01.2019 u mbajt Konferenca përmbyllëse për prezantimin e rezultateve të Fushatës “Ta Pastrojmë Kosovën”, organizuar nga Let’s Do It Kosova, në të cilën u fol për sukseset dhe sfidat e Fushatës tre mujore si dhe u bë ndarja mirënjohjeve për të gjithë kontribuesit në aktivitetet e Fushatës për tre muaj, si dhe u shpallën 10 komunitat fituese të grantit

prej 1.2 milionë eurosh, të ndarë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe 13 komunitat fituese të shportave dhe kontenjerëve. Në konferencë mori pjesë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, përfaqësues të ministrive të përfshirë në Task Forcën nacionale mjedisore, përfaqësues nga Forca

e Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës, të task forcave lokale, përfaqësues të shoqërisë civile dhe OJQ-ve, si dhe vullnetarë të shumtë. Gjatë kësaj konference ku ishin prezent mbi 200 pjesëmarrës, me mirënjohje u shpërblyen të gjithë ata që kontribuan në mbarëvajtjen e fushatës për pastrimin e vendit.



Më tutje, zyrtarët komunal të përfshirë në aksione të pastrimit, së bashku me Task Forcën kanë hartuar plane veprimi të cilat janë realizuar gjatë periudhës tremujore të pastrimit.

Lista e të dhënave nga të gjitha komunat e Kosovës më 15 shtator 2018 (numri i vullnetarëve, sasia e mbeturinave të mbledhura në ton dhe numri i thasëve të mbeturinave):

Komuna	Nr. i vullnetarëve	Sasia e mbeturinave të mbledhura (ton)	Numri i thasëve
Prishtinë	9650		4000
Gjilan	10000		2384
Obiliq	1000	20	
Suharekë	5000		4100
Kamenicë	200		2300
Hani i Elezit	850		1500
Deqan	1000		1700
Lipjan	1200	40	
Drenas	5195	32	
Istog	800		1700
Klinë	1000		1000
Malishevë	750	28	
Gjakovë	14000		7000
Rahovec	600	80	
Junik	1150	15	
Vushtrri	1500		2400
Viti	3000		1000
Shtime	1800		650
Kaqanik	600		500
Skënderaj	4700	52	
Dragash	1700	25	
Fushë Kosovë	170	5	
Artanë	230	6	
Ferizaj	10000		6000
Prizren	3250	13.6	
Podujevë	10000		2000
Pejë	15000		5000
Mitrovicë	4000	150	2300
Komunat Serbe (10)	1000		600
Totali	109345	316.6	46234

Aktivitetet 15 shtator - 15 dhejtor 2018

Me datë 17 shtator 2018, Task Forca e themeluar nga Qeveria e Kosovës ka mbajtur konferencë për media në të cilën u prezentuan rezultatet e punës së aksionit Ta Pastrojmë Kosovën, më 15 shtator 2018. Në këtë takim morën pjesë Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Fatmir Matoshi, Zëvendësministri në Ministrinë e Arsimit, Arbër Geci, Zëvendësministri në Ministrinë e Infrastrukturës, Rexhep Kadriu, Drejtori ekzekutiv i Let's Do It, Luan Hasanaj. Task Forca ka falënderuar të gjithë

pjesëmarrësit e aksionit të 15 shtatorit, duke shprehur kënaqësinë për të arriturat dhe rezultatet e datës 15 shtator dhe ka ftuar institucionet lokale dhe qëndrore të vazhdojnë me punën për largimin e deponive me intensitet dhe përkushtim sikur me datën 15 shtator. Derisa po mbahej konferenca për shtyp, vullnetarët e KVRL dhe Qendrës Rinore në Podujevë kanë organizuar aksion pastrimi në Liqenin e Batllavës.

Me datë 17 shtator 2018, aksioni Ta Pastrojmë Kosovën ka vazhduar në komunën e Ferizajit. Bau Market ka organizuar aksion pastrimi përgjatë brezit rrugor, si dhe largimin e disa deponive.




Aksioni i Bau Market, Ferizaj.



Ndësa me datë 18 dhe 19 shtator, 2018 është pastruar Liqeni i Mirushës






Me datë 20 Shtator, 2018 vullentarët e aksionit Ta Pastrojmë Kosovën kanë pastruar Kodrën e Kishnicës. Po në këtë datë është pastruar hapësira e objektit Dardania në Malishevë.



Me datë 21 dhe 22 Shtator, 2018 aksioni i pastrimit ka vazhduar pranë hapësirave të stadiumit Fadil Vokrri në Prishtinë. Në këtë aksion mori pjesë edhe Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj, gjatë këtij aksioni janë larguar 35 kamionë me mbetje ndërtimore dhe mbi 150 thasë me mbetje të tjera.



Dita botërore pa Makina me 22 shtator, 2018 është shënuar edhe në Kosovë. Dhjetëra qytetarë kanë defiluar me biçikleta me mesazhin që më shumë të përdorim biçikletat dhe mjetet tjera publike në menyrë që të ulët ndotja e ajrit. Në këtë aktivitet morën pjesë zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vullnetarë të Let's do It, klubet cikliste në Prishtinë si dhe qytetar.



Aksion pastrami nga HANDIKOS, nga ku u larguan disa thasë me mbeturina.



Edhe pse me datë 22 shtator Lets do it dhe vullnetarët e saj kishin pastruar hapësirat pranë stadiumit Fadil Vokrri, me 26 shtator përsëri kanë ndërmarrë aksion që të largojnë mbeturinat që ishin shfaqur në këto hapësira.



Me datë 28 Shtator, 2018 Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) i është bashkuar aksionit Ta Pastrojmë Kosovën duke angazhuar eskavatorët e saj kanë larguar deponitë ilegale në pjesë të ndryshme të Kas-triotit. Me datë 29 Shtator, 2018 Let's do It ka mbajtur punëtorinë për të diskutuar për të arriturat dy javore të aksionit Ta Pastrojmë Kosovën si dhe planet dhe qëllimet e përgjithshme të fushatës.



Punëtori Lets do It 29 shtator, 2018



Me datë 4 Tetor, 2018 Let's do It së bashku me ETC organizoi aksion pastrimi. Përpos pastrimit ETC vendosi që simbolikisht ndaloi shpërndarjen e broshurave informative deri në fund të fushatës Ta Pastrojmë Kosovën.

Me datë 1 Tetor, 2018 Les do It organizoi aksion pastrimi në në Plemetinë-Fushë Kosovë ndërsa me 3 Tetor, 2018 pati aksion pastrimi në Rahovec në Rrugët Bekim Isma dhe Hilmi Maliqi.

Me datë 5 tetor, 2018 Let's Do It organizoi aksion pastrimi në Milloshevë, Raskovë, Bakshi - Obiliq.



Me datë 7 tetor, 2018 Let's do It ka vazhduar me aksion të pastrimit në komunën e Vitisë. Vullnetarët kanë pastruar hapësirat afër varrezave të qytetit, hapësirat afër xhamisë dhe kishës katolike në Kabash, pastrimin e shtratit të lumit Morava e Binçës, rreth shëtitores në rrugën e Binçës dhe disa deponi të vogla në rrugën e Debelldehut deri tek pika kufitare me Republikën e Maqedonisë. Përveç pastrimit, u mbollën edhe pemë dhe u vendosën tabela me mesazhe vetëdijësuese. Në këto aktivitete mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti.



Me datë 8 tetor, 2018 OJQ Ti Bashkojmë Duart, Iniciativa e Femrës Kosovare në Gjakovë në kuadër të fushatës Ta Pastrojmë Kosovën së bashku me disa artistë të rinjë të qytetit bënë ngjyrosjen në disa objekte të qytetit që ishin në gjendje jo të mirë.



Aksionet e pastrimit në komunën e Gjakovës kanë vazhduar edhe më tutje. Kështu me datë 8 tetor aksion pastrimi kanë ndërmarrë personeli i Spitalit Regjional Isa Grezda në Gjakovë, duke pastruar ambientet përreth spitalit.



Me datë 10 tetor, 2018 aksionit ta Pastrojmë Kosovën iu bashkuan nxënësit e shkollës së mesme të ulët Hasan Prishtina, të cilët realizuan aksion pastrimi rreth hapësirave të saj.



Më datë 10 tetor, 2018 komuna e Prizrenit organizoi aksion pastrimi afër komunës. Pastrimi është zhvilluar përgjatë rrugës, me kamioneta në të cilën janë angazhuar tri kompani për mbledhjen e mbeturinave të vëllimshme.



Më datë 11 Tetor, 2018 Let's do It ka ndrmarrë aksion pastrimi pranë liqenit të Batllavës. Në këtë aksion kanë marrë pjesë rreth 100 aktivistë dhe vullnetarë, përfshirë nënkryetarin e komunës së Podujevës, OJQ Sundimi i Demokracisë dhe kompania e pastrimit Natyra e cila ka përdorur eksavator. Në këtë aksion janë grumbulluar mbi 150 thasë me mbeturina dhe janë larguar mbi 8-ton mbetje inerte. Në këtë aksion janë larguar tri deponi të mbeturinave si dhe një hapësirë përreth Liqenit (500 m gjatësi). Aksioni është organizuar në bashkëpunim me Task Forcën lokale të Komunës së Podujevës.



Me datë 12 tetor, 2018 Let's do it ka ndermarrë aksion pastrimi në komunën e Malishevë. Aksion është zhvilluar rreth lumit Mirusha, në qendër të qytetit dhe hapësirat rreth shkollave. Aksioni është përkrahur nga Drejtoria e Sherbimeve Publike, Drejtoria e Inspektoriatit, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpetim, kompania e pastrimit Ekoregjioni dhe shkolla fillore Ibrahim Mazreku.



Me datë 15 tetor, 2018 Let's do It ka organizuar aksionin e radhës në lagjen Matë1 në Prishtinë. Gjatë këtij aksioni kanë marrë pjesë banorë të lagjes, kompani private që operojnë në lagjen Matë 1, kompania e pastrimit Pastrimi si dhe vullnetarë të shumë të Lets do It. Në këtë aksion pastrimi janë larguar rreth 150 thasë me mbeturina.



Me datë 17 Tetor – Aksion pastrimi në Lipjan. Mbi 200 thasë me mbeturina dhe disa kamionë me mbetje inerte janë larguar nga tri lokacione gjatë aksionit të pastrimit në Lipjan, qindra vullnetarë i'u bashkuan aksionit i cili u mbajt në kuadër të Fushatës më të madhe në vend "Ta Pastrojmë Kosovën".



Me datë 18 tetor, 2018 let's do it ka organizuar aksion i madh pastrimi në Obiliq, ku u larguan qindra thasë me mbeturina si dhe një deponi me mbetje inerte nga eskavatorët e KEK-ut. Në këtë aksion kanë marrë pjesë me dhjetra vullnetar.



Po në këtë ditë me 18 tetor, 2018 aksione pastrimi ka pasur edhe në lagjën Taslixhe në Prishtinë, përkatësisht në rrugën "Pashtriku", nga ku janë larguar dhjetëra thasë me mbeturina, si dhe Komuna e Prishtinës ka marrë përgjegjësinë që të eliminojë një deponi ilegale të mbeturinave që gjendet rreth asaj rruge.



Aksione pastrimi për eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave kishte edhe në Malishevë, Gjakovë, Istog dhe në fshatin Pestovë të Vushtrrisë ku është larguar një ndër deponitë më të mëdha të mbeturinave.



Me datë 19 tetor, 2018 në lagjen O28 në komunën e Fushë Kosovës e cila është e banuar me qytetar të komunitetit Romë janë larguar 100 thasë me mbeturina dhe 11 kamion me mbetje inerte. Aksionit i'u bashkuan dhjetëra vullnetarë nga komuniteti romë, të cilët pastruan bashkë me vullnetarët e Lets do It.




Me datë 19 tetor, 2018 task forca komunale e Vushtrrisë së bashku me kompaninë WENDA, kanë organizuar aksion pastrimi për eliminimin e deponisë së madhe ilegale, në fshatin Pestovë. Kompania ofroi shërbime vullnetare me makineri, të cilët punuan tre ditë pandërprerë dhe larguan mbi 40 kamionë me mbetje inerte.



Po të njëjtën datë, aksion pastrimi ka pasur edhe në komunën e Malishevës ku është bërë pastrimi i përrorskës, apo degës së lumit Mirusha, që kalon nëpër qytetin e Malishevës si dhe hapësirën përreth stacionit të autobusëve. Pastrimin e kësaj dege të lumit Mirusha që kalon nëpër qytet e kanë bërë punëtorët e njësisë së "Eko Regjionit".



Me datë 20 tetor, 2018 në bashkëpunim me kompaninë e pastrimit Eko Regjioni është bërë pastrimi i rrugëve afër shkollës Profesionale dhe rrugëve tjera përreth lagjeve në Malishevë.



Me datë 20 tetor, 2018 është organizuar aksion pastrimi në komun të Junikut. Aksioni ka rezultuar me largimin e mbeturinave inerte dhe plastike, ndërsa u angazhuan edhe kompani private me makineritë e tyre dhe kompanitë e pastrimit.

Me datë 20 tetor, 2018 Komuna e Vitisë ka organizuar aksion pastrimi në fshatin Tërpezë. Aksioni ka filluar në vendin e quajtur Te Pishat. Aksionit përveq strukturave komunale ku ishte prezent edhe Kryetari Komunës si udhëheqës i task forcës, ju përgjigjën edhe këshilli i fshatit, shumë banor, personeli i shkollës së fshatit Tërpezë dhe puntorët e sektorit të Pyjeve. Përveq pastrimit, filloi edhe implementimi i projektit të komunës së Vitisë ku parashihen të ndërtohen dy fusha të gjelbërta (me bari të kultivuar, njëra për futboll dhe tjetra për volejball), si dhe vendosja e 20 ulseve dhe 20 shportave për hedhjen e mbeturinave, e të cilat do të hynë nën menagjimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Në këto aksione të pastrimit janë grumbulluar 56 thasë 100 L.

Me datë 21-22 Tetor, 2018 u ndërmorë aksion pastrimi në Komunën e Junikut. Ky aksion rezultoi me largimin e mbeturinave në disa deponi, ndërsa u angazhuan edhe kompanitë private "Joos Krasniqi" dhe "Shala" të cilët punuan dy ditë pandërprerë. Gjatë pastrimit ishin prezent edhe inspektorët komunal, të cilët ishin aktiv gjatë 2 ditëve të aksionit për bartjen dhe zbrazen e mbeturinave.



Me datë 23 tetor, 2018 së bashku me ekipin e Let's Do It dhe dhjetra deputet të Parlamentit të Evropës në mesin e të cilëve ishte edhe zv. Presidentja e Parlamentit znj. Heidi Hautala dhe raportuesi për Kosovën z. Igor Soltes pastruan hapësirat përreth ndërtesës së Parlamentit.



Me datë 23 tetor, 2018 është ndërmarrë aksion pastrimi në shkollën fillore Ndre Mjeda, fshatin Kabash ku është bërë pastrimi i oborrit të shkollës nga mbeturinat me ç'rast u mblodhën dhjetra thasë me mbeturina, rregullimi, grryerja dhe mbushja me dhe, përgaditja për mbjelljen e gjelbrimit si dhe bimëve dekorative. Këtij aksioni ju përgjigjen përveç institucioneve komunale edhe këshilli i fshatit Kabash, personeli i shkollës dhe nxënësit.



Me datë 24 tetor, 2018 është ndërmarrë aksion pastrimi në Prizren, ku janë pastruar tri deponi ilegale të mbeturinave: në Atmaxh, 3Nashec dhe një deponi ilegale në Rr. Hysen Rexhepi nga Kompania e Pastrimit "Eurovia".



Me datë 26 tetor, 2018 task forca komunale në komunën e Mitrovicës ka larguar gjashtë (6) deponi ilegale në disa pika në Mitrovicë, pastrimi i deponisë në aksin rrugor, pastrimi i deponisë ilegale - prapa ETC-së, brigjet e Lumit Iber, pastrimi i deponisë aksi Rrugor Vidishiq Bare, aksi Rrugor Mitrovicë-Lisice (Varrezat Ortodokse), pastrimi i liqenit artificial Mitrovica, lagjja e Romëve. Pos pastrimit të këtyre deponive, u pastrua edhe liqeni artificial Mitrovica.



Me 24 tetor, 2018 Aksion pastrimi në kampusin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", ku u larguan me dhjetëra thasë me mbeturina dhe u thirr që të promovohet edhe më tutje rëndësia e kujdesit ndaj mjedisit. Aksioni u organizua në bashkëpunim me Organizatën "Paqja studentore". Mori pjesë rektori Marian Dema, punëtorë të Rektoratit si dhe profesorë dhe studentë të UP-së.



Me 24, tetor, 2018 aksion pastrimika patur në Skënderaj ku u larguan mbeturina në disa deponi ilegale në disa pika si në Polac (1 deponi) janë larguar afërsisht 1.5 ton mbeturina inerte dhe të amvisërisë, Terrnafç (2 deponi) afërsisht 4 ton mbeturina, 3. Klinë e Epërme (2 deponi) 78 ton mbeturina inerte dhe të amvisërisë, Kryshefc (3 deponi) 66.5 ton mbeturina inerte dhe të amvisërisë, Marinë (2 deponi) afërsisht 32 ton mbeturina inerte dhe të amvisërisë, Prekaz (1 deponi) 17 ton mbeturina inerte dhe të amvisërisë, Lubovec (3 deponi) afërsisht 78 ton mbeturina, gjithësej 277 ton mbeturina.



Me datë 27 tetor, 2018 është zhvilluar aksion pastrimi në Gjakovë - Mbi 150 vullnetarë i janë bashkuar aksionit nga ku u larguan dhjetra thasë me mbeturina dhe mbi 20 kamiona me mbetje inerte. Aksionit i është bashkuar edhe Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, Lets Do It Kosova, organizata Iniciativa e Femrës Kosovare, IFK dhe qytetarët e bashkësisë së parë lokale.



Me datë 28 Tetor, 2018 u ndermorrë aksion pastrimi në fshatin Gadime të Komunës së Lipjanit ku u pastruan katër deponi ilegale të mbeturinave dhe u larguan rreth 400 thasë me mbeturina nga mbi 200 vullnetarë, zyrtarë qeveritarë e komunalë dhe qytetarë.



Me datë 29v tetor, 2018 u ndermorrë aksion pastrimi për herë të tretë përreth stadiumit Fadil Vokrri në Prishtinë, nga ku u larguan mbi 50 thasë me mbeturina. Në këtë aksion morrën pjesë edhe aktorët e serialit vendor "O sa mirë".




Me datë 29 tetor, 2018 Fillimi i eliminimit të deponisë ilegale të mbeturinave pranë Lumbardhit në fshatin Gorazhdevc të Pejës.



Po të njëjtën ditë, aksion pastrimi në Mitrovicë në tunelin e parë.



Në Drenas me datë 31 tetor, 2018 për disa ditë radhazi 7 deponi ilegale si Deponia të ish Kluzi, deponia tek Qikatova e Re dhe deponitë në fshatra Gllibar, Rr. Xhylani, Baic (afër SHFMU Migjeni, 5. Damaneh (Rr. veteranet e arsimit), Zabel i Ulët tek rruga Hagjaj dhe deponia në fshatin Krajkov.



Me datë 31 tetor, 2018 u ndërmorrë aksion pastrimi në Vushtrri nga ku u grumbulluan mbi katër mijë thasë me mbeturina dhe rreth 50 kamionë me mbetje inerte janë larguar nga pesë deponi ilegale të mbeturinave në Vushtrri. Aksionit i'u bashkuan mbi 500 vullnetarë. Aksionit i'u bashkua edhe kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri dhe zyrtarë të tjerë.



Me datë 1 nëntor, 2018 u ndërmorrë aksion pastrimi dhe vrapimi me Ambasaden Suedeze. Aksioni u realizua rreth hapësirave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe përfundoi me pastrimin e hapësirave përreth stadiumit të Prishtinës. Në këtë event morrën pjesë: Ambasadorja e Ambasadë së Suedisë në Kosovë dhe personeli, Lets Do It, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Lojtarët e Klubit të Prishtinës, si dhe vullnetarët e tjerë. Në këtë aksion u larguan rreth 100 thasë me mbeturina, të cilat janë klasifikuar sipas llojit të tyre në thasë me ngjyra përkatëse për secilin material.



Me datë 2 nëntor, 2018 u ndërmorrë aksion pastrimi në Skënderaj. Në këtë datë u pastruan pesë deponi ilegale të mbeturinave, deponia në hyrje të Skenderaj, deponia te tregu i vjetër, deponia te lumi Klina, deponi në Klinë e Poshtme dhe deponia tek Perroi i Keq. Në aksion morën pjesë ekipi i Let's Do It, kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari dhe zyrtarë të tjerë komunalë, si dhe vullnetarë të tjerë të shumtë.



Po në këtë datë, u ndërmorën aksione pastrimi në fshatin Mushnikovë, Prizren nga ku u mblodhën dhjetëra thasë mbeturina. Në këtë aksion morën pjesë përfaqësues nga komuna, nxënësit e shkollës fillore dhe e mesme e ulët dhe vullnetarë të tjerë.



Me datë 3 nëntor, 2018 në komunën e Vitisë në bashkëpunim me këshillin e fshatit Gërmovë janë pastruar të gjitha hapësirat publike. Pjesëmarrës të këtij aktiviteti ishin qytetarët e Vitisë dhe fshatit Gërmovë. Gjatë këtij aksioni janë grumbulluar rreth 100 thasë me mbeturina. Gjithashtu aktivitetet e pastrimit janë zhvilluar edhe në fshatin Ramjan, ku janë pastruar hapësirat publike në bashkëpunim me qytetarët si dhe me nxënësit e shkollës. Gjatë këtij aktiviteti janë grumbulluar rreth 80 thasë me mbeturina. Deponitë ilegale që u pastruan ishin: deponia në Begunce, deponia në Skifteraj, deponia në Devajë, dhe deponia në lokacionin Kabash, Smirë, Drobesh. Gjatë këtyre aktivitetëve në përgjithësi janë eliminuar rreth 12ton mbeturina.



Në të njëjtën ditë, u mbajtë trajnimi për ngritjen e kapaciteteve të mësimeve në fushën e mjedisit jetësor, organizuar nga Let's Do It. Ky trajnim ka rritur fokusin e mësimeve në temat që lidhen me edukimin mjedisor si dhe zhvillimin e aktiviteteve konkrete që promovojnë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit jetësor.



Me 4 Nëntor, 2018 u ndërmorë aksion pastrimi në Janjevë të Lipjanit. Gjatë aksionit u larguan mbeturinat përkaj rrugëve të Janjevës, si dhe u pastrua deponi e madhe me mbetje të përziera në këtë fshat. Aksionit i'u bashkua kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, kryetari i Janjevës, Behgjet Kongjelli, banorë përreth e vullnetarë të tjerë.



Me datë 5 nëntor, 2018 Aksion pastrimi në bashkëpunim me studentët e fakultetit të Edukatës Fizike, u pastrua hapësira rreth Kampusit Universitar të "Hasan Prishtina".



Prej datës 5 nëntor, 2018 e deri më datën 22 nëntor, 2018 komuna e Gjilanit në bashkëpunim me FSK-në kanë larguar deponi ilegale me mbeturina inerte në fshatin Kmetoc.



Me datë 6 nëntor, 2018 është ndërmarrë aksion pastrimi në Prishtinë, në rrugën "Tirana" në kryeqytet nga ku u larguan mbi 50 thasë me mbeturina.



Me datë 7 nëntor, 2018 komuna e Malishevës bashkë me vullnetarë dhe me kompaninë e pastrimit "Eko Regjioni" kanë bërë largimin e një deponie ilegale në qendër të qytetit, si dhe pastrimin e një prrocke të lumit Mirusha afër rrethit kryesor në hyrje të qytetit.



Me datë 7 nëntor, 2018 komuna e Malishevës bashkë me vullnetarë dhe me kompaninë e pastrimit “Eko Regjioni” kanë bërë largimin e një deponie ilegale në qendër të qytetit, si dhe pastrimin e një prrocke të lumit Mirusha afër rrethit kryesor në hyrje të qytetit.



Në kuadër të aksionit Ta Pastrojmë Kosovën aktivitetet vazhduan në Vushtrri, ku pas punës së pandalshme disa ditore, u pastrua deponia më e madhe ilegale në këtë qytet. Gjatë këtij aksioni kompania vullnetare Wenda ka larguar mbi 300 kamion me mbetje inerte nga kjo deponi.



Aksion është organizuar edhe në komunën e Skënderajit, në hapësirën afër xhamisë nga ku u larguan rreth 50 thasë me mbeturina.



Me datë 8 nëntor aksion pastrimi në Prishtinë ku larguan mbi 60 thasë me mbeturina përgjatë brezit të rrugës Xhorxh Bush, si dhe hapësirave afër Radio Kosovës dhe Kampusit Universitar.



Aktivite pastrimi me klubin e gjelbërt të shkollës së mesme teknike Lutfi Musiqi, Vushtrri. Aksion u organizua edhe në fshatin Sllovi të Lipjanit. Rreth 40 nxënës të shkollës fillore Hasan Zyko Kamberi në krye me drejtorin dhe me arsimtarë të shkollës, pastruan hapësirat rreth këtij fshati.



Me datë 9 nëntor, 2018 aksion pastrimi në fshatin Gurakoc të komunës së Istogut. Në këtë aksion pastrimi kanë marrë pjesë zyrtarë komunalë dhe shumë vullnetarë. Gjatë aksionit janë larguar më se 50 thasë mbeturina.

Në fshatin Gërmovë të Vitisë, në bashkëpunim mes komunës, këshillit të fshatit si dhe me qytetarët u organizua aksion pastrimi. Gjatë këtij aksioni është pastruar hapësira përkaj lumit të fshatit, tek ura dhe stacioni i autobusëve. Nga ky aktivitet janë larguar 40 thasë me mbeturina, si dhe kjo hapësirë është rrafshuar dhe përgatitur për rregullimin e një miniparku. Poashtu, në këtë datë në krye me kryetarin e Vitisë Sokol Haliti, u organizua aktivitet pastrimi, rregullimi i hapësirave publike, dhe largimi i deponive ilegale. Hapësira që u pastrua ishte ish baza e Kforit në Viti. Në këtë aktivitet është larguar një deponi ilegale me rreth 32 ton mbeturina. Mbeturinat e larguara janë transportuar për në deponinë regjionale në fshatin Velekincë të Gjilanit. Në këtë aksion të pastrimit morën pjesë përfaqësues nga komuna, shërbimet publike dhe qytetarët.



Task Forca Komunale në Vushtrri, Let's Do It Kosova, Koordinatorët Lokal të MMPH, kompania e pastrimit "UNITETI", në Vushtrri organizuan aktivitet për pastrimin e deponive ilegale dhe ambientit përreth.



Organizata partnere GAC ka trajnuar nxënësit e Klubit të Gjelbër të shkollës Mihail Grameno në komunën e Fushë Kosovës, sot dhanë kontributin e tyre të çmuar në pastrimin e hapësirës shkollore dhe ngritjen e vetëdijes qytetare.



Me datë 10 nëntor, 2018 është ndërmarrë aksion pastrimi në Gërmi. Gjatë këtij aksioni është eliminuar një deponi e madhe me mbetje inerte përkajë brezit rrugor dhe dhjetra thasë me mbeturina.



Aksion u zhvillua edhe në komunën e Gjilanit. Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim me KRU Hidromorava, dhe banorët e fshatit kanë ndërmarrë aksion për pastrimin e ambientit nga mbeturinat inerte.



Me datë 10 nëntor, 2018 punëtoritë për ngritjen e kapaciteteve të mësimeve në fushën e mjedisit jetësor kanë vazhduar në komunën e Podujevës. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 25 mësime.



Me datë 11 nëntor, 2018 aksioni Ta Pastrojmë Kosovën ka vazhduar në komunën e Vitisë ku janë pastruar hapësirat publike udhëkryqi Viti-Kabash-Smirë, hapësirat publike në fshatin Ramjan, fshatin Terpezë Te Pishat, fshati Pozheran, fshatin Germovë dhe Smirë.



Me datë 12 nëntor, 2018 Lets do It ka ndërmarrë aksion pastrimi në shkollën Model në Prishtinë dhe në afërsi të hekurudhës. Në aksion u bashkuan rreth 100 nxënës të shkollës Model dhe mësime.



Me datë 13 nëntor, 2018 aksion pastrimi në Lagjen e Romëve në Komunën e Mitrovicës. Në aksion morën pjesë mbi 100 vullnetarë nga ku u larguan rreth 100 thasë me mbeturina dhe 6 kamionë me mbetje të përziera, të larguara nga kompania Uniteti.



Me datë 13 nëntor, 2018 janë larguar katër deponi ilegale në qytet dhe fshatrat Llapashticë, Katunishtë, Livadicë dhe Bugurdoll të Lupçit të Poshtëm të komunës së Podujevës.



Aksion pastrimi në komunën e Podujevës në të cilën është bërë pastrimi i shtratit të lumit Llap, dhe punime në zgjerimin dhe rregullimin e shtratit në pjesën në dalje të qytetit.



Aksion pastrimi në komunën e Vushtrrisë ku u largua një deponi dhe është pastruar ambienti përreth shkollës fillore A. Z. Çajupi me githësej 10 kamion dhe 50 thasë me mbeturina të llojeve të ndryshme nga plastika e deri tek ato inerte.



Aksion për pastrimin e hapësirës prapa Shtëpisë së Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani”, në Viti. Këtij aksioni përveç zyrtarëve komunal ju janë bashkangjitur edhe vullnetarë të shumtë të cilët kanë mirëpritur rregullimin e kësaj hapësire.



Me datë 14 nëntor, 2018 aksionet vazhduan në Zhegër të Gjilanit ku janë larguar 10 kamionë me mbeturina.



Tryezë me rajonin e Prishtinës: Me datë 14 nëntor, 2018 Let's do it organizoi tryezë me qëllim të diskutimit të të arriturave të komunave në fushatën e pastrimit nga data 15 shtator e deri më 14 nëntor, 2018. Në tryezë morën pjesë zyrtarë nga Zyra e Kryeministrit, zyrtarë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe kryesues të task forcave komunale të komunave të rajonit të Prishtinës, si Obiliqi, Podujeva, Lipjani dhe Drenasi. Gjatë tryezës, secila nga komunat ka prezantuar vështirësitë me të cilat janë përballur gjatë fushatës, Po ashtu, në tryezë u theksua edhe nevoja që fushata për pastrimin e Kosovës të vazhdojë gjatë tërë vitit e jo vetëm gjatë tre muajve.



Aksioni i pastrimit me datë 14 nëntor ka vazhduar në komunën e Kamenicës. Në këtë aksion kanë marrë pjesë rreth 100 vullnetarë, të cilët larguan mbi 100 thasë me mbeturina në disa zona në fshatin Shipashnicë e Poshtme. Në kuadër të aksionit, është larguar një deponie e madhe me mbetje interte. Të pranishëm në aksionin kanë qenë ekipi i Let's Do It, Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, Ministri i Zhvillimit Ekonomik Valdrin Luka, kryetari i komunës Qëndron Kastrati, nënkryetari i komunës dhe njëkohësisht edhe koordinatori i Task Forcës Faton Jakupi si dhe vullnetarë të shumtë.



Po në këtë datë u ndërmorë aksion pastrimi dhe u bë rrafshimi i hapësirës prapa shtëpisë së Kulturës Gursel e Bajram Sylejmani në Viti. Në këtë aktivitet morën pjesë zyrtarë komunal, Policisë së Kosovës, OJQ-ve lokale edhe shumë qytetarë. Aksionit ju ka bashkangjitur edhe një ndërmarrje private me një eskavator dhe një kamion, mbi 100 pjesëmarrës me ç'rast janë larguar 20 thasë mbeturina dhe 11 ton mbetje të përziera të cilat janë larguar me makineri.



Aktiviteti tjetër i pastrimit të ambientit në disa pjesë të qytetit të Vitisë. Në aksion kanë marr pjesë 50 vullnetarë, zyrtarë komunal, puntorë nga kompania e pastrimit. Në këtë aksion janë grumbulluar 30 thasë mbeturina.



Me 15 nëntor 2018 është mbajtur tryeza e radhës në rajonin e Mitrovicës me qëllim të diskutimit të të arriturave të komunave në fushatën e pastrimit nga data 15 shtator e deri më 15 nëntor, 2018. Let's Do It në këtë datë kishte filluar të bëjë edhe me shpërndarjen e uniformave dhe mjeteve të punës për punëtorët e pastrimit. Në tryezën e sotme në Mitrovicë morën pjesë zyrtarë nga Zyra e Kryeministrit, zyrtarë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe kryesues të task forcave të komunave të rajonit të Mitrovicës, si Mitrovica, Vushtrria dhe Skënderaj.




Drejtorja për Administrimin e Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna i'u bashkua aksionit Ta Pastrojmë Kosovën. Në bashkëpunim me banorët e fshatit Haxhaj dhe banorë tjerë vullnetarë, kanë organizuar aksion pastrimi përgjatë rrugës që shpie deri në fshatin Haxhaj.



Aksion pastrimi në hapësirat e shkollës fillore Kajtaç Ramadani në Kijevë ku drejtori i kësaj shkolle, mesimdhënësit dhe nxënësit kanë përkrahur aksionin dhe kanë bërë pastrimin e hapësirave në oborrin e shkollës dhe jashtë saj. Në këtë aksion kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Policisë së Kosovës stacionit Malishevë.



Me datë 15 nëntor, 2018 është bërë pastrimi, rrafshimi dhe përgatitja për gjelbrimin e hapësirës e cila gjendet në Stubëll, ku janë larguar 6 ton mbeturina dhe janë dërguar në deponinë regjionale në Gjilan.



#tapastrojmekosoven

Hello. These days in Kosovo are being organized activities for cleaning Kosovo from waste,

Alpinistja e parë shqiptare nga Kosova që është ngjitur në majën më të lartë në botë, Everestin me 8848 metra lartësi mbidetare, Uta Ibrahim, i është bashkuar fushatës Ta Pastrojmë Kosovën. Nga 7200 metra lartësi mbidetare në majën e gjashtë më të lartë në botë, Cho Oyu, Uta ka dhënë një mesazh për të gjithë qytetarët që të bëhen pjesë e aktiviteteve të fushatës më të madhe në vend për ruajtjen e mjedisit Ta Pastrojmë Kosovën.

“Këto ditë në Kosovë janë duke u organizuar aksione për pastrimin e mbeturinave të Kosovës. Unë sot jam drejt ngjitjes së majës së gjashtë më të lartë në botë Cho Oyu. Për momentin jam në 7200 metra lartësi mbidetare. Gjatë ekspeditave të mija të 14 majave, unë promovoj Kosovën dhe bukuritë e saj. Andaj, sot për juve kam një mesazh. Ta pastrojmë, ta ruajmë dhe ta duam Kosovën”, thuhet në video-mesazhin e Uta Ibrahimit.



Me datë 15 nëntor, 2018 është bërë pastrimi, rrafshimi dhe përgatitja për gjelbrim e hapësirës e cila gjendet në fshatin Skifteraj, tek ura e Skifterajt, rruga për fshatin Radivojc, ku janë larguar 5 ton mbeturina me mekanizëm dhe 30 thasë mbeturina me vullnetarë të cilat janë dërguar në deponinë regjionale në Gjilan.



Me datë 16 nëntor, 2018 është ndërmarrë aksion pastrimi në komunën e Skënderajit. Gjatë këtij aksioni janë pastruar oborret e dy shkollave Hamëz Jashari dhe Shaban Jashari, dy rrugë afër shkollave në qytet Gjergj Fishta dhe rruga Sala dhe Hamit Jashari, poashtu është larguar edhe një deponi e shpërndarë afër shkollës. Nga ky aktivitet janë larguar mbi 30 thasë me mbeturina, dhe kanë marrë pjesë rreth 30 nxënës të gjimnazit Hamëz Jashari, koordinatorët lokal.



Me datë 17 nëntor, 2018 mbi 100 thasë me mbeturina janë mbledhur nga dhjetëra vullnetarë në një aksion pastrimi në Liqenin e Badovcit. Aksioni u fokusua tek pastrimi i hapësirave përskaq brezit rrugor, ndërsa thasët e mbledhur nga vullnetarët u larguan nga kompania Pastrimi.



Aksion pastrimi pranë varrit të Dëshmorit Afrim Bajraktari në Polluzhë-Rahovec.



Në komunën e Klinës u zhvillua trajnimi “Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve në fushën e mjedisit jetësor”, duke synuar shtrirjen graduale të kulturës mjedisore në të gjitha komunat e Kosovës.



Me datë 18 nëntor, 2018 në Podujevë janë larguar disa deponi ilegale në rrugën “Ftorja” dhe në rrugën Gallapi.



Në Lipjan është bërë mbjellja e 420 fidaneve dekorative në parkun e qytetit. Lipjanit po i shtohen hapësirat gjelbëruese dhe parqet bashkë me këndin e lojrave për fëmijë.



Me datë 19 nëntor largohet një deponi e madhe mbeturinash në Gjilan. Lokacioni i ashtuquajtur Te Pishat.



Në Drenas janë eliminuar deponi ilegale të mbeturinave, në lokacione të ndryshme si fshati Godanc dhe Gradicë.



Me datë 20 nëntor, 2018 në Vushtrri u ndërmorrë aksion pastrimi i deponisë tek vendi i quajtur Te Kisha.



Me datë 20 nëntor u pastrua deponia tek vendi i quajtur Te ura në fshatin Dobrashevc, Drenas.



Me datë 21 nëntor 2018, është mbajtur tryeza e radhës me komunat e rajonit të Gjilanit dhe Ferizajit me qëllim të diskutimit të të arriturave të komunave në fushatën e pastrimit nga data 15 Shtator e deri më tani.



**Me datë 22 nëntor, 2018 është mbajtur tryezë me qëllim të diskutimit të të arriturave të fushatës Ta Pas-
trojmë Kosovën nga 15 shtatori e deri më 22 nëntor, 2018 në Prizren. Në tryezë u diskutua për të arrit-
urat që shënuan komuna e Prizrenit, Suharekës dhe Malishevës, me largimin e dhjetëra deponive ilegale
të mbeturinave, caktimin e lokacioneve për mbetje interte, si dhe mbjelljen e qindra fidanëve. Po ashtu,
përfaqësues të task forcave lokale njoftuan se inspektorët tashmë kanë filluar edhe me shpërndarjen e
gjobave për ndotësit. Komunat e këtij rajoni u zotuan se do ta vazhdojnë angazhimin e tyre për zgjerimin
e hapësirave të gjelbra, si dhe mirëmbajtjen e zonave që veçse janë pastruar.**



**Me datë 23 nëntor është mbajtur trajnimi mbi temën Vullnetarizmi për mjedis me 27 nxënës të shkollës
së mesme Hivzi Sylejmani në Fushë Kosovë. Si rezultat i këtij trajnimi, ekipi i Let's Do It së bashku me
nxënësit kanë vendosur që të organizojnë aksion pastrimi në hapësirën përreth kësaj shkolle, ku marrën
pjesë rreth 200 nxënës.**



Në komunën e Gjilanit në lagjen Porodin, është ndërmarrë aksion për eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave. Për largimin e këtyre deponive kompania "AGI DANI" ka ofruar makinerinë e saj.



Mbi 50 thasë me mbeturina dhe gjashtë kamionë me mbetje interte janë larguar nga njëra prej deponive më të mëdha në Komunën e Pejës, e lokalizuar në fshatin Nakëll, i cili banohet me shumicë nga komuniteti RAE. Përveç ekipit të Let's Do It, morën pjesë mbi 50 vullnetarë, banorë të fshatit si dhe zyrtarë komunal.



Aksion pastrimi në komunën e Skenderajit. Punëtorët e kësaj komune dhe të kompanisë publike të pastrimit UNITETI, larguan afër 3 ton mbetje në një ndërtesë të braktisur afër postës, ku ndërhyrja me makineri ishte e pamundur.



Në Drenas është ndërmarrë aksion për eliminim e deponive në lokacionin e fshatit Krajkovë dhe deponia në destinacionin e fshatit Poterk.



Task Forca Komunale në Vushtrri, Let's Do It, Koordinatorët Lokal të MMPH dhe kompania e pastrimit UNITETI në Vushtrri, organizuan aktivitetet për pastrimin e deponive ilegale dhe ambientit përreth.



Me datë 24 nëntor 2018, mbi 50 thasë me mbeturina dhe 12 kamionë me mbetje inerte janë larguar gjatë aksionit të pastrimit në një deponi, në fshatin Dobrevë të Komunës së Fushë Kosovës. Në aksion morën pjesë dhjetëra vullnetarë.



Aksion pastrimi ka pasur edhe në fshatin Shtitaricë të Komunës së Vushtrrisë. Aksionit i janë bashkuar mbi 60 vullnetarë, të cilët kanë arritur të grumbullojnë mbi 200 thasë me mbeturina. Ky ka qenë një nga aksionet më të mëdha në këtë komunë pa ndihmën e makinerisë, pasi gjatësia totale e hapësirës së pastruar nga vullnetarët i kalon 3.5 km. Për mbajtjen e aksionit ka patur koordinim gjithëpërfshirës të akterëve, duke filluar nga ekipi i Let's Do It, koordinatorët e MMPH-s, përfaqësues të Task Forcës lokale, drejtori i shkollës fillore "Bahri Kuqi", Bilall Pllana, kryetari i fshatit Shtitaricë Mentor Hasani si dhe kryetari i këshillit prindëror, Nevzat Pllana. Aksioni u realizua në rrugën kryesore të fshatit, përgjatë hekurudhës, trotuareve, oborrit të shkollës si dhe hapësirës përreth.



Në komunën e Skënderajit, është mbajtur trajnimi "Ngritja e kapaciteteve të mësimit në fushën e mjedisit jetësor", organizuar nga Let's Do It. Trajnimi, i organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe Drejtorinë Komonale të Arsimit në Skënderaj, synon rritjen e fokusit të mësimit në temat që lidhen me edukimin mjedisor si dhe zhvillimin e aktiviteteve konkrete që promovojnë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit jetësor. Në trajnimin e sotëm pjesëmarrës ishin 20 mësimit të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta të komunës së Skënderajit. Këto trajnime dy-ditore, përveç Skënderajit, janë mbajtur edhe në Istog, Klinë dhe Podujevë, ndërsa do të vazhdojnë edhe në komunat tjera. Në fokus të këtyre trajnimeve janë mësimit të nivelit filor, si dhe mësimit të shkencave të natyrës, konkretisht Biologjisë dhe Kimisë në shkollat e mesme të ulëta.



Me datë 25 nëntor 2018, është ndërmarrë aksion pastrimi në lagjen Arbëria në Prishtinë, ku janë larguar dhjetëra thasë me mbeturina dhe tetë kamionë me mbetje inerte nga një deponi e madhe e mbeturinave. Pas përfundimit të aksionit, u vendos tabela e cila tregon se lokacioni është pastruar në kuadër të fushatës Ta Pastrojmë Kosovën dhe se nuk lejohet hedhja e mbeturinave aty. Dhjetëra thasë me mbeturina u mblodhën nga vullnetarët, ndërsa mbetjet inerte janë larguar nga makineri nga Kompania Mati.



Me datë 27 nëntor 2018, është zhvilluar aksion pastrimi në dalje të fshatit Radivojcë komuna e Vitisë, me ç'rast është eliminuar një deponi ilegale me 12 ton mbeturina dhe 60 thasë mbeturina. Mbeturinat e larguara janë transportuar për në deponinë regjionale në fshatin Velekincë të Gjilanit. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues nga komuna, punëtorët e kompanisë regjionale Higjiena, punëtorët e drejtorisë së shërbimeve publike dhe qytetarë vullnetarë.



Me datë 30 nëntor 2018, në komunën e Gjilanit është pastruar lokacioni afër "Stadiumi i Dritës". Pas një pune intensive nga kompania Bejta Commerce u bë eliminimi i deponive përreth stadiumit.



Me datë 30 nëntor, 2018 dhjetra vullnetarë i janë bashkuar aksionit në Doganaj të Ferizajit, ku arritën të largojnë mbi 200 thasë me mbeturina, ndërsa me makineri u larguan 5 kamionë me mbetje të përziera. Aksionit i'u bashkuan edhe përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zyrtarë komunal si dhe banorë të lagjes.



Në po të njëjtën ditë, aksioni ka vazhduar në fshatin Nekovc në komunën e Drenasit, ku nga aty u larguan disa deponi ilegale.



Me datë 1 dhjetor 2018, mbi 350 thasë me mbeturina dhe 30 kamionë me mbetje interte janë larguar gjatë pastrimit në pesë lokacione të ndryshme në rrugën magjistrale Prishtinë – Pejë, përkatësisht në fshatrat Gllarevë dhe Dollc. Prezent ishte edhe kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj, i shoqëruar nga kryetari i komunës së Klinës, Zenun Elezaj dhe gjenerali John Boyd, nga KFOR-i Amerikan.




Po në këtë datë vullnetarët e Let's Do It, vazhduan aksionin në lagjen Arbëria në Prishtinë, nga aty larguan mbi 50 thasë me mbeturina nga një deponi ilegale.



Gjithashtu, është mbajtur trajnimi i radhës "Ngritja e kapaciteteve të mësimit në fushën e mjedisit jetësor". Trajnimi u mbajt në komunën e Vitës, ndërsa morën pjesë 35 mësimit. Ky trajnim që u organizua në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe Drejtorinë Komonale të Arsimit në Viti, synon rritjen e fokusit të mësimit në temat që lidhen me edukimin mjedisor si dhe zhvillimin e aktiviteteve konkrete që promovojnë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit jetësor.



2 Dhjetor 2018, janë larguar mbi 200 thasë me mbeturina nga dhjetëra vullnetarë që i'u bashkuan aksionit të pastrimit në Mitrovicë, afër Kolegjit IBCM, nga e cila zonë për më shumë se 10 ditë radhazi janë larguar rreth 600 kamionë me mbetje të ndryshme nga disa deponi. Përveç ekipit të Let's Do It Kosova, aksionit i'u bashkua edhe Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi dhe zyrtarë të tjerë nga MMPH, kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri dhe zyrtarë të tjerë komunal, si dhe disa punëtorë të Kompanisë ETC.



Me 4 dhjetor 2018, është ndërmarrë aksion pastrimi përreth hapësirave të Qendrës Rinore në Komunën e Shtimes, nga ku janë larguar 50 thasë me mbeturina. Përveç ekipit të Let's Do It, aksionit i është bashkuar edhe kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli dhe zyrtarë të tjerë komunal, nxënës të Shkollës Emin Duraku, si dhe vullnetarë të tjerë.



Me datë 5 dhjetor 2018, Task Forca komunale në Vushtrri, Koordinatorët Lokal të MMPH dhe nxënësit e shkollës organizuan aktivitetet për pastrimin e hapësirave afër akademisë së policisë te banesat e bardha.




Punëtorët e KRM Uniteti, njësia në Vushtrri kanë vazhduar largimin e deponive ilegale.



Task Forca Komunale në Vushtrri, koordinatorët lokal të MMPH dhe kompania Uniteti në Vushtrri zhvilluan aktivitetet për pastrimin e deponive ilegale, pastrimin e lumit Podranqa, dhe ambientet përreth lumit.



Me 6 dhjetor 2018, Let's Do It bashkë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën e Podujevës organizuan takim me banorët e fshatit Orllan të Podujevës, për të diskutuar dhe gjetur zgjidhje mbi problemet mjedisore të cilat shqetësojnë banorët që jetojnë në zonën e liqenit të Batllavës.



Largimi i deponive ilegale në fshatin Maxhunaj, ku janë larguar dy deponi ilegale të deponuara që nga koha e pasluftës. Gjithashtu është bërë pastrimi në të dyja anët e rrugës nga Vushtria në drejtim të Mitrovicës, deri në afërsi të fshatit Dobellukë.



Task Forca Komunale në Vushtri, Koordinatorët të MMPH-se, Kompania Uniteti në Vushtri zhvilluan aktivitetet për pastrimin e deponive ilegale në Novosell të Maxhunit ku janë larguar 40 kamionë me mbeturina nga kjo deponi.



Me datë 7 dhjetor 2018, është ndërmarrë aksion pastrimi në zonën e XIII-të Shipashnicë e Epërme. Bashkarisht me task forcën komunale, është larguar deponia me mbetje të ngurta.



Në të njëjtën datë në komunën e Junikut kanë vazhduar aksionet e pastrimit.



Në anën tjetër ka vazhduar aksioni i pastrimit në degën e lumit Mushtisht, Suharekë.



Gjithashtu kanë vazhduar aksionet e pastrimit në fshatrat Drobesh dhe Smirë, komuna e Vitisë. Ky aksion është ndërmarrë nga komuna e Vitisë, respektivisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe ajo e Inspektionit, si dhe me mbështetje të shkollës fillore të fshatit Drobesh, disa vullnetarëve të këtij lokaliteti, ndërmarrjes Eko-Higjiena dhe ekipit të pastrimit të qytetit të Vitisë. Gjatë pastrimit, janë grumbulluar 110 thasë mbeturina, si dhe 20 tonë mbeturina që janë deponuar në deponinë regjionale në Gjiilan.



Në komunën e Skenderajit me 7 dhjetor 2018, janë eliminuar 7 deponi ilegale dhe 93 ton mbeturina. Ky aktivitet u zhvillua në dy vendbanime të komunës së Skenderajit në Dashefc dhe Baks, ndërsa në lokalitetin e Likofcit aksionit ju pergjigj Kompania Rukolli, e cila u përkujdes për mbledhjen e mbeturinave nga kjo deponi.



Me datë 7 dhjetor 2018, në Drenas është eliminuar deponia ilegale në fshatin Fushicë e ulët dhe San-kovc



Me datë 8 dhjetor 2018, Let's do It ka organizuar festival mjedisor në Liqenin e Badovcit ku janë organizuar aksione pastrimi, diskutim me nxënës për tema mjedisore, lojëra të ndryshme e debate.



Komuna e Drenasit ka vazhduar me aktivitetin për pastrimin e deponive ilegale përgjate rrugës Zabeli lartë tek vendi i quajtur Quka, Drenas, Komoran afër lapidarit.




Aksion pastrimi ne komunën e Vushtrrisë. Aksionin e organizoi Imami Behar Dushi nga Xhamia e Martireve në Vushtri. Gjatë këtij aksioni janë pastruar hapësirat rreth Xhamisë dhe varrezave në qytet.



Me datë 9 dhjetor 2018, komuna e Podujevës, ka bërë pastrimin dhe zgjerimin e shtretërve të lumenjëve dhe hapjen e pastrimin e kanaleve të ujit. Konkretisht, ka përfunduar pastrimi i shtetit të lumit në fshatin Bajcinë dhe pastrimi i disa kanaleve në fshatin Gerdoc.



Aksion pastrimi në komunën e Drenasit në të cilin është bërë pastrimi i deponive ilegale në afërsi të Feronikelit.



Me datë 10 dhjetor aktivitet pastrimi në komunën e Suharekës në fshatin Bershanc, Doberdelan-Pagarush, mbi varrezat e fshatit Gelancë, në fshatin Kosterrc, Peqan, Reshtan përgjatë autostradës, Reshtan te varrezat dhe te vrella, Semetisht, Shirokë, Studeqan dhe deponia në fshatin Terrnje.



Aktivitet pastrimi të deponive ilegale në komunën e Gjakovës. Gjatë këtij aksioni është pastruar rruga Tivari në Gjakovë nga ku është larguar një deponi me mbeturina.



Komuna e Gjakovës me aktivitete të njëpasnjëshme për eliminimin e deponive ilegale. Gjatë këtij aktiviteti është pastruar deponia në qendër të qytetit prapa kurrizit (një pjesë me dyqane).



Komuna e Junikut eliminon dy deponi, njëra në Lagjen Krasniqi, përkatësisht në rrugën Junik-Pacaj ku është eliminuar deponia me mbi 40 ton mbeturina, dhe deponia tjetër tek Llugat e Begut nga ku është eliminuar një sasi me mbi 10 tone mbeturina.



Komuna e Drenasit eliminon deponinë tek Aeroporti Poklek i ri dhe Poklek i vjetër.



Me datë 11 Dhjetor, 2018 aksion pastrimi në zonën e kampusit universitar në Gjakovë.



Mbi 200 thasë me mbeturinat janë larguar nga dy lokacione në komunën e Rahovecit tek varrezat e qytetit të Rahovecit, për të vazhduar pastaj te ura e Drenocit, ku u pastrua brezi rrugor. Përveç ekipit të Let's Do It Kosova, në aksion morën pjesë edhe kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi dhe zyrtarë të tjerë komunal si dhe nxënës të Gjimnazit "Xhelal Hajda – Toni". Aksioni i nisur nga vullnetarët vazhdoi edhe gjatë ditës me makineri.



Me datë 12 dhjetor 2018, aksion pastrimi në lagjen Kalabria nga ku u larguan disa deponi ilegale, dhe aksioni i dytë ka vazhduar tek rrethi "Te Ismeti" në Prishtinë, nga ku u larguan rreth 50 thasë me mbeturina.



Qindra vullnetarë i janë bashkuar aksioneve të pastrimit me nxënësit e shkollës së mesme Hivzi Sylejmani në Fushë Kosovë, ku përveç hapësirave përreth shkollës, u pastrua edhe rruga deri tek Parku i Qytetit si dhe hapësira brenda parkut. Në këtë aksion u mbledhën mbi 150 thasë mbeturina nga nxënësit dhe vullnetarët e tjerë që i'u bashkuan aksionit.



Komuna e Malishevës në bashkëpunim me kompaninë Burimi NNT kanë berë largimin e deponive ilegale në fshatin Carrallukë dhe Drenoc. Malisheva vazhdon të jetë njëra ndër komunat e cila që nga fillimi i aksionit me 15 shtator 2018 e deri më tani nuk është ndalur me pastrimin e hapësirave të ndryshme publike.



Komuna e Drenasit ka pastruar lokacione, në Negrovc ku janë larguar dy deponi ilegale, Korrotic të lartë, tek shkolla dhe tek rrethi, Gjurgjic afër shkollës, Llapushnike, tek lagja Thaqi, në Likoshan janë eliminuar dy deponi, Dobroshevc te lagja Prenku.



Me datë 13 dhjetor 2018, Pastrimi i shtratit të Lumit Llap.



Në fshatin Krushë e Madhe të komunës së Rahovecit, është bërë pastrimi i një deponie ilegale të mbeturinave në qendër të këtij fshati. Largimin e mbeturinave nga kjo deponi e ka parë edhe kryetari i komunës, Smajl Latifi, Berat Duraku, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Inspektorë komunal, qytetarë të fshatit Krushë e Madhe dhe vullnetarë të Qendrës Rinore SHL-Kosova.



Pastrimi i deponisë në Pasomë të komunës së Vushtrrisë, e cila cilësohej si më e madhja ilegale në Kosovë.



Në komunën e Gjilanit është pastruar shtrati i lumit Stanishorka përgjatë Rr. Marie Shllaku.

Në ditët e fundit të fushatës Ta Pastrojmë Kosovën është organizuar aksion pastrimi në komunën e Ferizajt. Fillimisht, në magjistralen Prishtinë – Shkup, përballë Mileniumit është pastruar me makineri një deponi ilegale e mbeturinave. Largimin e mbetjeve e ka bërë në mënyrë vullnetare kompania Eskavatori. Më pas, aksioni vazhdoi me pastrimin e rreth një kilometër të brezit rrugor, nga rruga “Brahim Ademi”, përreth sallës së sportit Bill Clinton e deri te varrezat e dëshmorëve në qytetin e Ferizajit. Përgjatë këtij brezi rrugor vullnetarët arritën të largojnë mbi 50 thasë me mbeturina, ndërsa përveç ekipit të Let’s Do It dhe punëtorëve të kompanisë Eskavatori, aksionit i’u bashkuan edhe pjesëtarë të KFOR-it amerikan, zyrtarë komunal, nxënës të shkollës “Kuvendi i Arbërit”, si dhe kompania Pastërtia.



Me datë 14 dhjetor 2018, në ditët e fundit të fushatës Ta Pastrojmë Kosovën, komuna e Suharekës ka organizuar aksion pastrimi në fshatrat Biraq dhe Duhel. Gjatë këtij aksioni janë pastruar deponi në këto fshatra të komunës së Suharekës.

Sqarime shitesë:

Gjatë projektit tremujorë "Ta Pastrojmë Kosovën" është organizuar transporti për vullnetarë në të gjitha komunat e Kosovës, prej dates 15 shtator deri më 15 dhjetor 2018.

Rreth 50 mijë vullnetarëve u janë ofruar shujta ushqimi gjatë pjesëmarrjes së tyre në aksionet e pastrimit.

Është bërë xhirimi i aksioneve dhe është realizuar video reportazha për të gjitha aksionet dhe komunat gjatë projektit të pastrimit si dhe është realizuar video vetëdijësuese.

Komunave u janë dhuruar tabela me mesazhe për ruajtjen e mjedisit.

Paraprakisht është bërë hartëzimi i të gjitha deponive ilegale përkaj brezeve rrugore.

Promovimi i aktiviteteve në rrjetet sociale, web portale, gazeta ditore etj, e gjithë kjo për të rritur imaktin e fushatës.

Është angazhuar makineri e rëndë për bartjen e materialeve inerte në komunat e Kosovës etj.

TA 15 SHTATOR 2018
15 DHJETOR 2018

PASTROJME
KOSOVEN

